




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 196/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Blerim Dina– Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, z.Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “NNT Eing Com”-Podujevë kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku për kontratë është rekomanduar operatori ekonomik “Eko Group shpk & Rexha Shpk” lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull të prokurimit: “Ndërtimi parku i diellit, tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616-18-120-521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë” më datën 29.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “NNT Eing Com”-Podujevë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi parku i diellit, tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616-18-120-521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- “KK-Prishtinë”

II. VËRTETOHET njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull “Ndërtimi parku i diellit, tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616-18-120-521 AK-KK-Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“NNT Eing Com”-Podujevë” aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:18.10.2018

Hapja e ofertave është bërë me dt:14.11.2018

Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit e eliminuar: 10.04.2019

Data e vendimit të AK-së për dhënie të kontratës: 10.04.2019

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik“NNT Eing Com”-Podujevë me dt: 15.04.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues- “KK-Prishtinë” me datën 18.04.2019 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE:“NNT Eing Com”-Podujevë si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “NNT Eing Com”-Podujevë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.04.2019 me nr. 196/19,kundër vendimit të AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Ndërtimi parku i diellit,tek kompleksi i Banesave të Bardha” me numër të prokurimit : 616-18-120-521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Prishtinë” duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7,59,69të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe neni 41 RrUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 14.05.2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues profesional në raportin e dt:17.05.2019, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues "NNT Eing Com"-Podujevë në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues se është shkelur Neni 7, Neni 59, Neni 69 dhe Neni 41 se AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e rekomandimit për kontratë të Grupit të OE: EKO GROUP SHPK, REXHA SHPK dhe se nuk e ka respektuar Vendimin 750/18 të OSHP-së të datës 31.01.2019, Eksperti fillimisht sqaron se në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë të kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar "Paisjet e nevojshme: 1 eskavator 3 kamiona 1 cilindër 1 traktor për frezim me të gjitha paisjet adekuate" dhe si dëshmi "Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit".

Eksperti sqaron se për këtë aktivitet të prokurimit është dhënë një Vendim nga ana e OSHP-së me numër 750/18 i datës 31.01.2019 që lënda të kthehet në ri vlerësim e në të cilin për pajisjen "traktor" ndër të tjera thuhet që "Paneli shqyrtues konform shkresave të lëndës, deklarimit të palëve në procedurë konstaton se qëndron ky pretendim ankimor pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar një faturë të blerjes duke mos dëshmuar se i ka të gjitha pajisjet e kërkuara në dosje të tenderit. Për më tepër nuk ka asnjë dëshmi mbi rregullsinë teknike dhe regjistrimin e traktorit, ashtu siç kërkohet në dosje të tenderit.

Eksperti sqaron se pas pranimit të Vendimit nga OSHP, AK ka kthyer aktivitetin e prokurimit në ri vlerësim duke formuar komision të ri vlerësimit, vlerësimi i ofertave është përfunduar me datë 12.03.2019, ku të ndër të tjera thuhet që "... për traktor OE i rekomanduar për dhënie ka ofruar librezë qarkullimi për një mjet tjetër –traktor tjetër. Pas kërkesës për sqarime të bërë në procesin e rivlerësimit OE nuk i ka sjellë dëshminë (librezën e qarkullimit) të kërkuara për pajisjen – traktorin që e ka dorëzuar në ofertë por për pajisje tjera dhe si i tillë konsiderohet i papërgjegjshëm (ka ofruar Certifikatë të regjistrimit të automjetit me targa "01-628-VA" për "Traktor me kabinë 2 dyer"). Përkundër rekomandimeve të ndryshme brenda komisionit vlerësues, komisioni vlerësues me shumicë rekomandon Grupin e Operatorëve Ekonomikë EKO GROUP SHPK, REXHA SHPK për dhënie të kontratës." Më pas, me datë 15.03.2019, AK ka pranuar Kërkesë për rishqyrtim nga OE NNT EING COM SHPK dhe më pas me datë 18.03.2019 AK ka pezulluar e më pas ka aprovuar si pjesërisht të bazuar Kërkesën për rishqyrtim duke e kthyer aktivitetin në ri vlerësim.

Pas kësaj, është formuar komisioni i ri për vlerësim të ofertave që ka përfunduar vlerësimin me datë 10.04.2019, prej të cilave vendimeve që kanë rrjedh nga ky vlerësim është bërë edhe ankesa në OSHP.

Në fund, Eksperti sqaron se pas shqyrtimit të dokumentacionit për projektin në fjalë sipas raportit të vlerësimit të tenderëve AK ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për dhënie që të ofrohet certifikata e regjistrimit për traktor dhe se OE ka ofruar dëshminë e kërkuar - ka ofruar dokumentin me titull "Certifikata e regjistrimit të automjetit" me targa "01-920-VA" për "Traktor me kabinë 2 dyer" me datë të regjistrimit të parë 01.04.2019. Në bazë të kësaj, Eksperti sqaron pika ankimore e OE ankues është e qëndrueshme pasi që regjistrimi i pajisjes traktor është bërë pas datës së hapjes së projektit gjë që është në kundërtim LPP dhe sipas nenit 39.3 të RrUOPP thuhet që "Megjithatë, lejohet që një Autoritet Kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë se kanë ekzistuar para afatit të fundit të dorëzimit të aplikacionit apo të dorëzimit të tenderit".

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar (për arsyet që u ceken tek përgjigjen në pretendimin e sipër përmendur nr. 1) dhe të anulohet Vendimi i AK për dhënie dhe lënda të kthehet në ri vlerësim

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 20.05.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 22.05.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 29.05.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i OE-së z. Podvorica deklaroj: Pajtohem plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues profesional që lënda të kthehet në rivlerësim sepse kjo lende është shtjelluar dhe pretendimet ankimore janë shtjelluar në vendimin e OSHP-së nr 750/18 të datës: 31.01.2019. Procesi i hapjes së ofertave për këtë procedurë ka qenë 14.11.2018 ndërsa dokumentet që ka ofruar OE i propozuar për dhënie të kontratës saktësisht Libreza e Regjistrimit me Targë: 01-920-VA është me datë të regjistrimit të parë 01.04.2019 e që i bie që është ndryshim material.

Gjatë prezantimit në seance përfaqësuesi i AK-së znj. Sekiraqa deklaroj: Autoriteti Kontraktues nuk pajtohet me mendimin e ekspertesh shqyrtuese për faktin që në procesin e rivlerësimit është kërkuar librezë e qarkullimit për Traktor dokument i të cilit ka qenë fatura, ndërsa në momentin e librezës së qarkullimit për këtë pajisje, kjo pajisje ka qenë e regjistruar.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtues znj. Prebreza deklaroj: Në vendimin e fundit të OSHP-se për këtë AP me nr 750/18 ndër të tjera është thënë që nuk ka asnjë dëshmi mbi rregullsinë teknike dhe regjistrimin e Traktorit siç kërkohej në DT. Me pas Autoriteti Kontraktues ka kthyer lenden në rivlerësim dhe kanë qenë siç e kam shkruar edhe në ekspertizë 2 kërkesa për rishqyrtim. Në herën e 2-të është ofruar librezë e Traktorit por ka datë të regjistrimit të parë 01.04.2019 që i bie që regjistrimi është bërë pas datës së hapjes, dhe neni 39.3 i RrUOPP-së thotë që: dokumentet në mënyrë objektive duhet të prezantohen se kanë ekzistuar para afatit të dorëzuar të tenderit që i bie 5 muaj prapa.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë që ankesa jone të aprovohet plotësisht e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së deklaroj: Kërkojmë që të hedhet poshtë ankesa e OE ankues dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues se është shkelur Neni 7, Neni 59, Neni 69 dhe Neni 41 sepse AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e rekomandimit për kontratë të Grupit të OE: EKO GROUP SHPK, REXHA SHPK dhe se nuk e ka respektuar Vendimin 750/18 të OSHP-së të datës 31.01.2019. Paneli shqyrtues sqaron në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek kërkesat e Kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar “Paisjet e nevojshme: 1 eskavator 3 kamiona 1 cilindër 1 traktor për frezim me të gjitha pajisjet adekuate” dhe si dëshmi “Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, Deklaratat unike doganore - Librezat e qarkullimit”.

Paneli shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për dhënie që të ofrohet dëshmitë sipas kërkesë se AK-së për traktor dhe se OE në fjalë ka ofruar dëshminë e kërkuar - ka ofruar dokumentin me titull “Certifikata e regjistrimit të automjetit” me targa “01-920-VA” për “Traktor me kabinë 2 dyer” me datë të regjistrimit të parë 01.04.2019. Mirëpo sipas deklarimit të përfaqësuesit të AK-

së në procesin e rivlerësimit është kërkuar librezë e qarkullimit për Traktor dokumenti i të cilit ka qenë fatura.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës për dëshmitë lidhur me traktorin e kontestuar nga ankuesi ka ofruar Deklaratat unike doganore-fatura, të cilat dëshmi konsiderojmë se e plotësojnë kërkesën e autoriteti kontraktues dhe se duke pas parasysh faktin se dëshmitë e ofruara me rastin e rivlerësimit nga ana e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës përmbajnë vetëm devijim të vogël që nuk mund të shkaktoj ndryshim material për aktivitetin e prokurimit në fjalë, paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi vlerësimi i ofertave nga ana e AK –së me rastin e rivlerësimit është në pajtim me nenin 59.4 të LPP-së.

Po ashtu paneli shqyrtues me rastin e vendimmarrjes mori parasysh edhe nenin 6 të LPP-së për faktin se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofertuar edhe çmim me të ulët sesa operatori ekonomik ankues andaj me këtë rast mund të vijmë në përfundim se operatori ekonomik i rekomanduar e për dhënie të kontratës në përgjithësi ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –“KK-Prishtinë”

1x1 OE- “NNT Eing Com”-Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z.Blerim Dina

